



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/100
Datë: 23.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 99 Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/100
Datë: 23.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 32.1 të Ligjit Nr. 2004/17 Për Mbrojtjen e Konsumatorëve, nenit 10, paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-131 për Ndryshim dhe Plotësimin Ligjit Nr. 2004/17 Për Mbrojtjen e Konsumatorëve, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Programi i Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorit.
2. Detyrat lidhur me përcaktimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorit, veçanërisht përcjelljen dhe evidentimin e punëve të kryera nga Programi i Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorit, i udhëheqë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
3. Ngarkohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/100
Datë: 23.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve; Rom, Ashkali, Egjiptian 2009 - 2015.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Zyra për Çështje të Komuniteteve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/100
Datë: 23.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia e Punësimit 2010 - 2012.
2. Mekanizmi efektiv i menaxhimit dhe koordinimit të Strategjisë do të ndërtohet me këto organe:
 - 2.1 Komision Ndërministror (KNM), i cili do të ketë rol mbikëqyrës të Strategjisë. Ai do të jetë përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm strategjik dhe do të ofrojë udhëzime për zbatimin e Strategjisë përmes takimeve të tij për çdo dy vjet. Komision Ndërministror do të ushtrojë edhe funksionin e mbikëqyrjes strategjike dhe do të jetë përgjegjës për të bërë organizimet e nevojshme për sigurim të cilësisë. Komisioni Ndërministror do të përbëhet nga:
 - a) Zëvendëskryeministri Ramë Manaj - Kryesues;
 - b) Ministri i Ekonomisë dhe Financave;
 - c) Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;
 - d) Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - e) Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - f) Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
 - g) Në cilësinë e anëtarit, sipas nevojës, do të ftohen edhe partnerë tjerë relevantë.

2.2 Komisioni për Menaxhim të Strategjisë (KMS), i cili do të jetë përgjegjës për të ofruar koordinimin e punës për Strategjinë, do të ofrojë udhëheqje teknike dhe përmbajtjesore lidhur me aktivitetet e parapara në planin Vjetor të Punës dhe do të ofrojë këshilla teknike. Ky komision gjithashtu do të jetë përgjegjës për menaxhimin e resurseve të Strategjisë për të arritur rezultatet dhe veprimet e përkufizuara në Strategji dhe për të shqyrtuar problemet e menaxhimit dhe zbatimit që dalin në pah. Komisioni për Menaxhim të Strategjisë do të takohet për çdo tremujor, por nëse parashtrohet nevoja do të zhvillojë takime edhe më të shpeshta, varësisht nga nevoja, për të shqyrtuar çështje të lidhura drejtpërdrejt me menaxhimin dhe zbatimin e programit. Komisioni për Menaxhim të Strategjisë do të përbëhet prej përfaqësuesve nga:

- a) Zyra e Kryeministrit;
 - b) Ministria e Ekonomisë dhe Financave;
 - c) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - d) Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - e) Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
 - f) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
 - g) Oda Ekonomike e Kosovës;
 - h) Sindikatat;
 - i) Partnerët tjerë dhe ekspertët mund të ftohen në takimet e Komisioni për Menaxhim të Strategjisë, sipas nevojës.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucione tjera për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/100
Datë: 23.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/100
Datë: 23.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet, me vërejtje, Projektligji për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.
2. Ngarkohet Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit që në tekstin e Projektligjit t'i inkorporojë vërejtjet e miratuara nga Qeveria.
3. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi, pas inkorporimit të vërejtjeve, t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë